



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2, pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-28/2008), nenit 2.3 dhe nenit 8, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-27/2008), nenit nënëve, 28. 2, pika (f), 29. 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën----- miraton:

Projekt-RREGULLORE

PËR

TARIFAT, NGARKESAT DHE GJOBAT

NGA SHERBIMET DHE VEPRIMTARIT KOMUNALE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

QËLLIMI

Neni 1.

Me këtë Rregullore caktohet lartësia e tarifave dhe ngarkesave për shërbime nga veprimtaritë komunale, që do t'i paguajnë personat fizikë dhe juridikë në emër të shërbimeve komunale, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve, apo sipas detyrës zyrtare, lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë tregtare, lejeve për shërbime profesionale, pronësisë së automjeteve motorike, përdorimit apo shfrytëzimit të pronës komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, shfrytëzimin e burimeve natyrore, të hyrave nga qiradhënia dhe gjobat komunale - gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale.

II. LARTËSIA E TARIFAVE DHE NGARKESAVE

Neni 2.

Lartësia e tarifave dhe ngarkesave që do të paguajnë personat fizikë e juridikë, në emër të shërbimeve apo veprimtarive komunale sipas drejtorive, në pajtim me këtë Rregullore, do të jenë, si vijon:

Neni 3.

Tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE INSPEKTORATIT

	Nr.R.	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
Sektori i përgjithshëm	1	Për pranimin e kërkesës	1.00
	2	Vërtetimi i fotokopjes-formati A4x1	0.50
	3	Vërtetimi i fotokopjes-formati A3x1	1.00
	4	Për fotokopjimin dhe vërtetimin e identitetit nga arkivi.	3.00
	5	Vërtetimi i deklaratës mbi raportin e lidhjes familjare	2.00
	6	Vërtetimi i deklaratës që personi është i vetëm	2.00
	7	Vërtetimi i deklaratës mbi vendqëndrimin e përkohshëm	2.00
	8	Vërtetimi i deklaratës mbi varshmërinë materiale	2.00
	9	Për huazimin e dokumenteve te lejueshme nga arkivi	5.00
	10	Vërtetimi i deklaratës mbi nacionalitetin e qytetarit (kombësin)	2.00
	11	Vërtetimi i deklaratës që nuk gjendet në marrëdhënie pune	1.00
	12	Vërtetimi i deklaratës mbi mbikëqyrjen e anëtarit te familjes	2.00
	13	Vërtetimi i deklaratave të ngjashme varësisht nga kushtet aktuale	2.00
	14	Vërtetimi i deklaratës mbi jetën e përbashkët deri në vdekjen e bashkëshortit.	1.00
	15	Për ankesa të ndryshme	2.00
	16	Për përkthimin e dokumenteve - (për faqe)	5.00
	17	Për përpilimin e autorizimit - pëlqimit	5.00
	18	Për përpilimin e kërkesave, deklaratave etj	4.00
	19	Për vërtetim të autorizimit – pëlqimit	3.00
	20	Për ankesa që paraqiten kundër vendimit të cilin e bien organi i shkallës së parë, paguhet tarifa në shumën prej	20.00
Certifikatat – Sektori i Ofiqarisë	21	Kërkesa për certifikatë të lindjes	1.00
	22	Kërkesa për certifikatë të martesës	1.00
	23	Kërkesa për certifikatë të vdekjes	0.00
	24	Për aktvdekje (trashëgimia)	5.00
	25	Për ceremoninë e lidhjes se martesës	7.00
	26	Për regjistrimin e mëvonshëm te faktit te lindjes	10.00
	27	Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjes (*deri në 5 vjet: €5, kur se pas 5 viteve: €10.00)	5.00 10.00
	28	Për ndërrimin e emrit personal (deri në moshën 18 vjeçare) (mbi moshën 18 vjeçare) (* për pensionistet 50% zbritje këtu)	15.00 50.00
	29	Për korrigjimin e shënimeve në librat amë, Nëse ka qen gabim i Komunës të jetë falas	5.00 0.00
	30	Për lidhje të martesës jashtë orarit te punës	40.00
	31	Për lidhje të martesës jashtë selisë (zyrave) të Komunës	70.00
	32	Për lidhje të martesës, kur njeri bashkëshort është shtetas i huaj	50.00
	33	Për deklaratë te bashkësisë familjare (për përdorim ne Kosovë)	1.00
	34	Për deklaratë te bashkësisë familjare jashtë Kosove	5.00
	35	Për regjistrimin në librat special të lindjeve, martesave(jashtë Kosovës)	2.00
	36	Për vërtetimin e shtetësisë	2.00
	37	Për vërtetimin që personi është në jetë	3.00

38	Për certifikatë të statusit të lirë martesor	5.00
39	Për vërtetim të vendbanimit ose vërtetime tjera	1.00
40	Për konfirmim lënda e martesës, me kërkesë të DRGJC	3.00
41	Për konfirmim të certifikatave, LAL, LAM e tjera	1.00
42	Për lidhje të martesës me shtetas të huaj (jashtë orarit të punës)	70.00
43	Për lidhje të martesës me shtetas të huaj jashtë orarit dhe jashtë selisë së komunës.	100.00
44	Për nëpunësinë zyrtar në lidhje të martesës (jashtë orarit dhe jashtë selisë) nga pala duhet të bëhet kompensimi për mëditje në shumë prej:	30.00
45	Personat dhe Subjektet e liruar nga pagesat në shërbimet e Drejtorisë për Administratë dhe Inspektion	
46	Rastet sociale (dëshmia nga Qendra për Punë Sociale – vlefshmëria e kartelës)	0.00
47	Familjarët e Dëshmorëve të luftës (Prindërit, Bashkëshortet, dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare)	0.00
48	Invalide të luftës me shkallë të invaliditetit mbi 50% (Vendimi nga organi kompetent mbi shkallën e invaliditetit)	0.00
49	Familjarët e viktimave të luftës	0.00
50	Personat e hendikepuar me shkallë mbi 50%	0.00

Neni 4.

Tarifat në sferën e inspeksionit

Shpenzimet për daljeve të organeve të inspeksionit në terren për shqimin e objekteve (lokale të punës, pajisjeve, veglave, stabilimenteve etj) të parapara me dispozitat për kushtet minimale higjieniko-sanitare dhe teknike, mbrojtjes në punë, mbrojtjes së mjedisit për fillimin e bizneseve të reja dhe atyre ekzistuese i bartin ushtruesit e biznesit dhe parashtruesi i kërkesës si vijon:

Sektor i Inspeksionit	Nr.R.	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
		1	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe deri në 20 m²
	2	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 20-50 m²	30.00
	3	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 50-100 m²	40.00
	4	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 100 m²	100.00
	5	Pëlqimi sanitar	60.00
	6	Pëlqim komunikacioni	60.00
	7	Pranim teknik për auto taksì.	30.00
	8	Kërkesë për kontroll inspektues për personat fizik	10.00
	9	Kërkesë për kontroll inspektuese për subjekt afarist (persona juridik) dhe institucionet tjera	20.00
	10	Kërkesë për asgjësim të mallrave	30.00
	11	Kërkesë për dalje në terren nga PTK-ja	100.00
	12	Kërkesë për dalje në terren nga KEK-u	100.00
	13	Kërkesë për dalje në terren nga subjektet tjera simotra	100.00
	14	Kërkesë për dalje në teren për Hidroregjionin jugor dhe kompaninë për menagjimin e mbeturinave “Ekoregjioni” dhe kompanitë tjera simotra	50.00

Neni 5.

Zyra e prokurimit

Tarifa për pjesëmarrje në tender për një operator	10.00
---	--------------

Neni 6.

6.1 Tarifë (ngarkesat) për ushtrimin e veprimtarive afariste

DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE BUXHET

Nr.	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
1	Kompanitë publike nacionale	1200
2	Kompanitë publike regjionale	1000
3	Kompanitë dhe filialet bankare	1200
4	Kompanitë mikrofinancare dhe mikrokreditore	700
5	Kompanitë e pagesave dhe këmbimeve	350
6	Kompanitë dhe filialet e kompanive që merren me sigurimin e automjeteve, pasurisë, personave dhe sigurimeve të tjera	700
7	Kompanitë që merren me sigurimin fizik	250
8	Ndërmarrjet ndërtimore-ndërtimi i ulët dhe i lartë	300
9	Ndërmarrjet e specializuara për ndërtim	200
10	Ndërmarrësit e vegjël	100
11	Prodhuesit e pijeve alkoolike	350
12	Prodhuesit e pijeve joalkoolike	200
13	Prodhuesit e materialit ndërtimor	300
14	Prodhuesit dhe përpunuesit e lëkurës dhe materialeve të ngjashme	250
15	Prodhuesit e mobilieve	250
16	Prodhuesit e materialit për ambalazh nga plastika	250
17	Prodhuesit e materialit për ambalazh nga letra	150
18	Prodhuesit dhe përpunuesit e arit, argjendit dhe metaleve të tjera të çmuara	350
19	Prodhuesit e materialit elektrik	300
20	Prodhuesit e gypave PVC	300
21	Prodhuesit e tekstilit, tepihëve dhe produkteve tjera të ngjashme	300
22	Prodhuesit e dymëve, dritareve dhe elementeve të tjera të ngjashme nga alumini dhe plastika	300
23	Prodhuesit e dymëve, dritareve dhe elementeve të tjera të ngjashme nga druri	250
24	Prodhuesit e elementeve të metalit	300
25	Prodhuesit e ngjitëseve dhe gjelatinës	200
26	Prodhuesit e fasadave, materialeve suvatuese dhe materialet tjera përcjellëse	300
27	Prodhuesit e sfungjerit dhe materialeve të tjera të ngjashme	200
28	Prodhuesit e produkteve të mishit	250
29	Prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit dhe produkteve nga qumështi	200
30	Prodhuesit dhe përpunuesit e produkteve ushqimore	200
31	Prodhuesit tjerë (produkteve higjienike, sanitare, etj),	300
32	Përpunimi i drurit, llamarinës, plastikës, gurit etj	300
33	Shtypshkronjat	300

34	Ndërmarrjet botuese	300
35	Ndërmarrjet tregtare me shumicë	300
36	Ndërmarrjet tregtare me pakicë	250
37	Depot e materialit ndërtimor	300
38	Agjensionet turistike	350
39	Transportuesit e udhëtarëve (nacional dhe ndërkombëtar)	400
40	Transportuesit e udhëtarëve (komunal)	200
41	Transportuesit e materialeve të rrezikshme	400
42	Transportuesit e materialeve ndërtimore	300
43	Transportuesit e specifik	400
44	Ndërmarrjet e autotaksive	300
45	Ndërmarrjet e kombi-taksive	350
46	Taksitë individuale (kanë një taksi dhe punojnë pronarët)	50
47	Gurëthyesit	300
48	Seperacionet e rërës	300
49	Hotelet	600
50	Motelet	450
51	Restorantet deri në 100 m ²	250
52	Restorantet nga 101 m ² deri në 300 m ²	300
53	Restorantet nga 301 m ² deri në 500 m ²	400
54	Restorantet mbi 500 m ²	500
55	Piceritë, bifete, gjellëtoret dhe servuesit e vegjël të ushqimit	150
56	Disko baret	300
57	Klubet e natës	500
58	DJ	50
59	Grupet muzikore	100
60	Kafiteritë deri në 50 m ² (përfshihen fajtorët)	120
61	Kafiteritë nga 51 m ² deri në 100 m ²	180
62	Kafiteritë mbi 100 m ²	220
63	Kafiteritë që ngarkohen me m ² (ngarkesa për 1 m ²)	2.5
64	Ëmbëltoret	100
65	Parkingjet private (taksa për m ²)	0.25
66	Kompanitë e shpedicionit	250
67	Tregjet e hapura dhe të mbyllura tjera	250
68	Kompanitë ndërmjetësuese në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme	350
69	Kooperativat bujqësore	100
70	Fermtat e shpezëve dhe kafshëve	150
71	Blefaritë	liruar
72	Mullinjtë elektrik me industrinë e përpunimit dhe prodhimit nga mielli	400
73	Mullinjtë elektrik	300
74	Barnatoret bujqësore	150

75	Barnatoret shëndetësore	350
76	Shërbimet veterinare	100
77	Frigoriferët	50
78	Mishtorët	150
79	Thertoret	100
80	Bukëpjekësit	200
81	Përpunimi i pemëve dhe perimeve	100
82	Kultivuesit e pemëve dhe perimeve	liruar
83	Kultivuesit e drunjtëve dekorativ	liruar
84	Lulishtet	50
85	Pikat e karburanteve	700
86	Pikat e gasit	100
87	Radio	50
88	TV	100
89	Kiosqet	100
90	Artizanatit	50
91	Dyqanet e vogla (deri në 50 ^m)	200
92	Dyqanet tjera	200
93	Marketet (deri në 150 m ²)	300
94	Super marketet (mbi 150 m ²)	400
95	Tregtarët lëvizës	20
96	Produksionet e artit, dizajnit, mediave dhe të tjera	200
97	Autoserviset (autolimar, automekanik, autoelektrik, vullkanizer etj)	300
98	Riparimi dhe servisimi i pajisjeve elektrike	150
99	Riparimi dhe servisimi i pajisjeve elektronike dhe informative	100
100	Autolarjet	50
101	Kontrollimi teknik i automjeteve	300
102	Renta Car	300
103	Varrezat e automjeteve	120
104	Varrezat dhe rikoperuesit e mbeturinave të metaleve	120
105	Varrezat dhe rikoperuesit e mbeturinave jo metaleve	50
106	Shërbimet e internetit dhe TV-kablloviqe	300
107	Shërbimet e elektrikes, elektronikës, sistemeve të sigurisë etj	200
108	Kazinotë	3.000
109	Bastoret	1.500
110	Lojërat e fatit	1.500
111	Lojërat e ndryshme (bilardo, video lojëra dhe të ngjashme)	100
112	Pishinat	300
113	Fusha sportive të hapura	50
114	Fusha sportive të mbyllura	150
115	Klubet sportive	200

116	Shërbimet e pastrimit	250
117	Dhënia me qira e mjeteve të punës	200
118	Riparimi i makinave të imëta	50
119	Floktarët për meshkuj dhe për femra	200
120	Sallonet e ondulimit	350
121	Fotografët	200
122	Pastrim kimik	100
123	Përpunuesit e mermerit dhe granitit	200
124	Veprimtaritë tjera profesionale	150
125	Ndërmarrjet e tjera shërbyese	150
126	Agjensionet tjera profesionale	150
127	Avokatët	400
128	Shërbimet juridike	200
129	Përkthyesit	100
130	Ordinancat mjekësore private	250
131	Klinikat mjekësore	400
132	Laboratorët	150
133	Autoshkollat	150
134	Rëntgenit	250
135	Noterët	200
136	Shërbimet e kontabilitetit dhe financave	150
137	Auditorët	150
138	Kompanitë projektuese	200
139	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	200
140	Arsimi fillor	250
141	Arsimi i mesëm	300
142	Arsimi universitar	500
143	Arsimi tjetër dhe kurset	50
144	Fizioterapeutet	250

6.2 Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të transaksioneve (shitblerjeve) të paluajtshmërive, transferimin e pasurisë, dhuratave dhe trashëgimive, caktohen në mbështetje të Udhëzimit administrativ NR AKK 2006/1

1.	Për vlerën e transaksionit deri në 10.000.00 €	20.00
2.	Për vlerën e transaksionit prej 10.000.00 € deri në 20.000.00 €	30.00
3.	Për vlerën e transaksionit prej 20.000.00 € deri në 40.000.00 €	40.00
4.	Për vlerën e transaksionit prej 40.000.00 € deri në 50.000.00 €	50.00
5.	Mbi vlerën e 50.000.00 €, për çdo 10.000.00 € tejkalim Por shuma e tarifës së përgjithshme nuk mund ta kalojë vlerën 200.00 €	10.00
6.	Po qe se vlera e kontratës-transaksionit është e pa vlerësueshme	70.00

6.3 Tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare në DEFB-në

1.	Certifikatat mbi kryerjen e obligimeve dhe Çertifikata të ngjashme	1.00
2.	Certifikatat për kursime pensionale invalidore (zejtarët).	1.00
3.	Certifikata për gjendjen ekonomike dhe financiare	1.00
4.	Për mbajtjen e muzikës në lokale publike paguhet taksa ditore	15.00
5.	Kërkesat për zvogëlimin e tarifë ngarkesave	1.00
6.	Vërtetimet e kontratave për shkëputjen e bashkësisë familjare	5.00

6.4 Tarifat për lejet e pronësisë së automjeteve

Të gjithë pronaret, bizneset ose etnitete tjera që kanë në pronësi të tyre të gjitha llojet e automjeteve motorike që regjistrohen dhe paguajnë sigurimin e automjeteve brenda vitit i caktohet ngarkesa më sa vijon:

Automjetet deri në 3.5 ton ngarkohen	10.00
Automjete mbi 3.5 ton ngarkohen	20.00

Tarifat për lëshimin e lejes së lartpërmendur do të paguhet në Komunë me ngarkesë dhe në bazë vjetore ose me rastin e regjistrimit të automjeteve në qendrën për regjistrimin e automjeteve.

Vërejtje: Nga ngarkesa për leje të automjeteve motorike lirohen familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe personat me aftësi të kufizuar. Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit.

6.5 Tarifat për parkimin e automjeteve

1.	Tarifat për automjetet motorike deri në 3.5 t për një orë	0.25
2.	Tarifat për automjetet motorike mbi 3.5 t për një orë	0.50

6.6 Tarifat për dhënien e lejes së për punë gjatë ditës së fundit të vikendit dhe me gjatë se orari i plotë i punës.

Subjektet të cilat dëshirojnë të punojnë gjatë ditëve të vikendit duhet të marrin leje të veçantë nga drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet.

Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet është e obliguar ta njoftoj me shkrim drejtorin e administratës dhe inspeksionit për çdo leje të dhënë.

Pagesave bëhet për muaj sipas ngarkesave të mëposhtme:

Nr	Aktiviteti	Ngarkesa (€) për muaj	Ngarkesa (€) për orë
1	Subjektet afariste të cilët merren me shitjen e karburanteve	40	0.2

3	Objektet hoteliere (restorantet, kafe- baret, dyqanet hoteliere	40	0.2
4	Super marketet	30	0.15
	Marketet	20	0.1
5	Dyqanet	20	0.1
6	Ndërmarrjet ndërtimore	30	0.15
7	Ordinancat private dhe barnatoret	20	0.1
8	Subjektet tjera afariste	10	0.1

6.6.1 Subjektet afariste të cilët aktivitetin e tyre biznesor e ushtrojnë në periferi nga rruga magjistrale ngarkohen 40% më ultë se tarifat e cekura më lartë.

6.6.2 Subjektet afariste të cilët aktivitetin e tyre biznesor e ushtrojnë në fshatra ngarkohen 70% më ultë se tarifat e cekura më lartë.

Duke u bazuar në specifikat e ndryshme ekonomike të komunës e cila ndikon në afarizmin e bizneseve në komunën e Suharekës janë përcaktuar **5 zona (sipas tabelës vijuese)**. Zona nga I deri në V, kanë zbritje sipas tabelës vijuese

Zona	Vendbanimet dhe lokacionet e përfshira	Zbritja nga tarifa bazë
I.	Përfshin të gjitha banesat, shtëpitë dhe lokalet afariste që gjenden përkaj rrugës “Brigada 123”, rruga magjistrale Suharekë-Prizren deri te “Ura e Sopsisë”. “Hajdin Berisha”, “Mulla Nura”, “Qendra zejtare numër Nr-1 dhe Qendra zejtare numër Nr-2	5%
II.	Përfshinë të gjitha shtëpitë dhe objektet afariste të cilat janë jashtë zonës së parë në brendi të qytetit	15%
III.	Përfshinë disa fshatra të Komunës së Suharekës siç janë: Sopi, Savrovë, Bukosh, Vraniq, Reqan, Dvoran, Popolan, Mushtishtë, Dubravë, Sallagrazhde, Grejkoc, Gjinoc, Gelancë, Leshan, Tërrnje, Neprëbisht, Samadrexhë, Studenqan, Reshtan, dhe Peqan	25%
IV.	4 Përfshinë fshatrat në zonat kodrinë malore të Komunës së Suharekës, këto fshatra janë: Bllacë, Duhël, Stravuqin, Krushic e Ulët, , Mohlan, Doberdelan, Semetisht, Nishor, Kosterc, Sllapuzhan	35%
V.	Përfshin fshatrat në zonat më të thella malore: Dëlloc, Maqitevë, Budakovë, Krushic e Eperme, Papaz, Vërshec, Qadraq, Grejqec, Luzhnicë, Javor	50%

6.7 Dispozitat e veçanta: (dispozitat lehtësuese për bizneset)

Çdo aktivitet afaristë që ka realizuar qarkullim në vitin paraprak nga **50.000,00€** deri në **100.000,00€**, i ngritet ngarkesa në taksë **+ 50%** (nuk përfshihet numri tarifor 1,2,3).

Çdo aktivitet afaristë që ka realizuar qarkullim në vitin paraprak nga, **100.000,00€** deri në **250.000,00€**, i ngritet ngarkesa në taksë **+ 150%** (nuk përfshihet numri tarifor 1,2,3).

Çdo aktivitet afaristë që ka realizuar qarkullim në vitin paraprak mbi **250.000,00€** i ngritet ngarkesa në taksë **+ 300%** (nuk përfshihet numri tarifor 1,2,3).

Nenet e mëparshme nuk e përjashtojnë mundësinë e aplikimit të ngritjes së ngarkesës edhe në vitin aktual nëse posedohet me informata faktike.

Çdo aktivitet primar ngarkohet **100%**, aktiviteti sekundar ngarkohet me **70%**, aktiviteti tercial ngarkohet me **50%**, ndërsa aktivitetet tjera ngarkohen me **20%**.

Të gjitha subjektet afariste që veprojnë në komunën e Suharekës, ndërsa selinë e kanë jashtë komunës së Suharekës nuk përjashtohen nga taksat dhe ngarkohen me tarifën bazë.

Bizneset afariste që operojnë në shumë lokacione mbrenda komunës, me firmë dhe aktivitet të njëjtë por me njësi të ndryshme ngarkohen me **50%** për çdo njësi, përveq njësisë kryesore.

Bizneset e reja lirohen nga taksa për ushtrim të vepritarisë afaristë për vitin në të cilin regjistrohen (ose për **1** (një) vit).

Bizneset e reja që regjistrohen për ushtrim të aktivitetit afarist prodhues në teritorin e komunës lirohen nga taksat për **3 vite**.

Bizneset e reja Artizanale që regjistrohen për ushtrim të aktivitetit afarist në teritorin e komunës lirohen nga taksat për **5 vite**.

Bizneset prodhuese që ushtrojnë aktivitet në teritorin e komunës dhe që janë të antarsuara në asociacionet përkatse të biznesit, lirohen **50 %** nga taksa për aktivitetin afarist prodhues.

Bizneset jo aktive dhe bizneset që për disa periudha kanë qenë joaktive lirohen nga taksat komunale për ushtrim të veprimtarisë afariste pasi që ti sjellin dëshmitë nga ATK dhe verifikimit të komisionit nga komuna.

Bizneset që ushtrojnë aktivitetet të pastër të bujqësisë dhe blegtorisë lirohen nga taksa për ushtrim të aktivitetit afarist për **10 vitet** e ardhshme duke filluar nga viti **2013**.

Bizneset që merren me veprimtari specifike dhe që janë të obliguara të kenë licenca profesionale janë të detyruara të pajisen me licenca.

Pagesat e taksës bëhen në katër rata të barabarta dhe atë për secilin tremujor.

Bizneset që i kryejnë obligimet e tyre vjetore deri më 30 qershor të vitit aktual, i lëshohet çertifikat dhe kartelë për parapagues me afat deri më 30 qershor të vitit vijues. Prezentimi i origjinalit të çertifikatës dhe kartelës si dhe lënja e një kopje është bazë e mjaftueshme për të mos u kushtëzuar për realizim të shërbimeve nga komuna. Kjo procedurë vlen në të gjitha drejtoritë e komunës

Neni 7.

7.1 Tarifat në sferën e shëndetësisë dhe mirëqeni sociale

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Kjo Drejtori realizon këto të hyra për tarifat dhe ngarkesat për qytetaret e Komunës së Suharekës:

Nr.R.	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
1.	Vërtetimi për nxënës dhe studentë për botën e jashtme:	5.00
2.	Vërtetimet mbi gjendjen shëndetësore të punëtorëve në botën e jashtme:	8.00
3.	Vërtetimet e llojeve të ngjashme të tjera	8.00
4.	Raporte konziliare të mjekëve për punëtor në botën e jashtme:	15.00
	Formulari për shpenzimet e varrimit	5.00
	Formular për pensionistet që kanë vendim të pensionit deri në 50€	1.00
	Formular për pensionistet që kanë vendim të pensionit mbi në 50€	5.00
5.	Vërtetimin për klient që nuk iu është marruar e drejta për të vepruar apo prindërore	5.00
6.	Vërtetimin për lirim nga shtëpia që nuk ka obligime	5.00
7.	Vërtetimin për pranim të shtetësi së Kosovës	2.00
8.	Vërtetimin që familja nuk merr asistencë sociale për shtete e jashtme	5.00
9.	Vërtetimi (mendimi) për martesë të parakohshme (hershme)	5.00
10.	Vërtetim për regjistrim të më vonshëm të fëmijëve	5.00
11.	Vërtetim që është duke u kujdesur për fëmijët	3.00
12.	Vërtetim që familja nuk merr asistencë sociale nga kjo tarifë lirohen (familjet në asistencë sociale, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, nxënës dhe studentë	1.00

7.2 Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese)

Lirimi nga tarifat dhe ngarkesat:

Familja e ngushtë e dëshmoreve (bashkëshortet, fëmijët dhe prindërit e tyre) lirohen nga pagesa.

Gjithashtu studentët dhe nxënësit lirohen nga pagesa në tarifë ngarkesa që kanë lidhje me shkollimin e tyre.

7.3 QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE(QKMF-ja)

Bazuar në nenin 12.7 të Ligjit për Shëndetësisë nr.2004/4 dhe Udhëzimit Administrativ 2006/6 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dhe Aktvendimit të Ekzekutivit të Komunës së Suharekës, drejtori i QKMF nxjerr:

Me anë të kësaj rregullore përcaktohen dhe sigurohen të gjitha të hyrat financiare nga bashkë pagesat që realizohen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Suharekë, nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, si dhe dispozitat e veçanta me anë të cilave parashihen kategoritë e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore që përjashtohen këto bashkë pagesa.

Me dispozita ligjore dhe udhëzime administrative në fuqi shfrytëzuesit potencial (që në ndonjë mënyrë nuk janë liruar nga shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore) janë të obliguar të paguajë tarifë ngarkesën për ofrimin e shërbimit shëndetësor në QKMF. Këta shfrytëzues të shërbimeve shëndetësore obligohen të participojnë për këto shërbime të paraqitura në mënyrë tabelore:

Çmimorja për tarifat dhe ngarkesat në mjekësinë e përgjithshme

Nr.R.	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
1.	Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00
2.	Ekzaminimi mjekësor ne QMF/QKMF me udhëzim të mjekut te familjes	2.00
3.	Ekzaminimi mjekësor në QMF/QKMF pa udhëzim të mjekut të familjes	4.00
4.	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6.00
5.	Medikamenti nga Lista Esenciale, ofruar në barnatoren publike	0.30
6.	Ultrazëri standard	3.00
7.	Radiografia	3.00
8.	EKG	0.50
9.	Analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina	1.00
10.	Analizat laboratorike (komplet)	5.00
11.	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometer sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00
12.	Audiograma	1.00
13.	Shpëlarja e veshit	1.00
14.	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.00
15.	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.00
16.	Dhënia e infuzionit	2.00
17.	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërimin e plagës (vetëm në vizitën e parë)	3.00
18.	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00
19.	Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsultimi i mjekëve	18.00
20.	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18.00
21.	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00
22.	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj-për një orë	25.00
23.	Çdo pacienti të cilit i ofrohet shërbim shëndetësor në urgjencë nga ora 20 ⁰⁰ deri në ora 8 ⁰⁰ pa marr parasysh moshën	1.00
24.	Transportimi i pacientit me autoambulancë brenda republikës së Kosovës dhe jashtë Republikës së Kosovës, pacienti paguan për kilometër	0.20
25.	Shtetasit e huaj dhe bartësit e sigurimeve të huaja shëndetësore do të paguajnë shërbimet e ofruara pesë herë më shtrenjtë sesa shtetasit e Republikës së Kosovës, për një shërbim që ka bashkë pagesë në lartësi prej 2€ shtetasi i huaj ose bartësi i sigurimit të huaj shëndetësor do të paguaj 10€	

Çmimorja për tarifat dhe ngarkesat në shërbimet stomatologjike

Nr.R.	EMËRTIMI (i ngarkesave, kompensimeve dhe taksave në shërbime)	Euro(€)
1.	Vizita e parë stomatologjike	1.00
2.	RTG i dhëmbit	1.50
3.	Mbushja e përhershme me amalgamë	4.00
4.	Mbushja e përhershme me kompozitë	5.00
5.	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme(amalgamë apo kompozitë)	5.00
6.	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
7.	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
8.	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
9.	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00

10.	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00
11.	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	6.00
12.	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00
13.	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00
14.	Vulosja e fisurave	1.00
15.	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00
16.	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurësve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00
17.	Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmbë)	1.00
18.	Nxjerrja e dhëmbit	1.50
19.	Incizioni intra dhe ekstra oral	1.50
20.	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00
21.	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.50
22.	Me dispozitat e tarifë ngarkesave të Komunës për shfrytëzimin e lokaleve me Qira, QKMF për një metër 2 (katror) realizon 5€ (Euro), me shfrytëzuesit e lokaleve të QKMF-së në ato lokacione ku shprehet interesi.	5.00 m ²
23.	Shtetasit e huaj dhe bartësit e sigurimeve të huaja shëndetësore do të paguajnë shërbimet e ofruara pesë herë më shtrenjtë sesa shtetasit e Republikës së Kosovës, për një shërbim që ka bashkëpagesë në lartësi prej 2€ shtetasi i huaj ose bartësi i sigurimit të huaj shëndetësor do të paguaj 10€	

7.4 Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese)

Përfshirja nga bashkë pagesat (tarifë ngarkesave)

Shërbimet shëndetësore dhe grupet e popullatës që janë të liruar nga bashkë pagesat janë:

1. Fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 15 vjeçare;
2. Nxënësit dhe studentët deri në fund të shkollimit të tyre;
3. Qytetarët mbi moshën 65 vjeçare;
4. Qytetarët, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës dhe llojet e tjera të invaliditetit, anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, si dhe shfrytëzuesit e skemave të përgjithshme të përkrahjes sociale dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre;
5. Personat me aftësi të kufizuara;
6. Kujdesi shëndetësor parandalues;
7. Kujdesi shëndetësor reprodaktiv, që përfshin masat e planifikimit të familjes dhe kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonisë;
